

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## V E N D I M

Nr. 93, datë 27.2.2019

## PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE DHE TË PAGESAVE PËR SHËRBIMET  
NDAJ INSTITUCIONEVE APO PERSONAVE, QË OFROHEN  
NGA AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Kërkesat e subjekteve të parashikuar në pikat 3, 6 dhe 9, të nenit 3, të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, për dhënie informacioni dhe/ose vënie në dispozicion të dokumenteve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, plotësohen kundrejt tarifave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij vendimi institucionet për të cilat marrja e shërbimit nga Autoriteti përcaktohet në ligj që të jetë pa pagesë.
3. Tarifa, në kuptim të këtij vendimi, është kostoja e riprodhimit të informacionit dhe/ose dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe e dërgimit të tij.
4. Personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, e përfitojnë informacionin dhe/ose dokumentacionin pa pagesë deri

në 20 fletë, për çdo kërkesë, ose në vlerën ekuivalente, kur informacioni jepet në një format tjetër, pas vërtetimit të statusit përkatës.

5. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga drejtoria/sektori përkatës, me mjetet e riprodhimit që disponon Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
6. Institucionet, personat dhe subjektet e interesuara, paguajnë tarifën përkatëse në llogarinë e Autoritetit pranë një banke të nivelit të dytë, sipas faturës së arkëtimit bashkëlidhur këtij vendimi. Me pagesën e tarifës përkatëse dhe paraqitjen e mandatit bankar pranë Autoritetit, dokumentet e kërkuara nga kërkuesi i dërgohen me postë, ose i dorëzohen kërkuesit/subjektit të interesuar.
7. Të ardhurat e realizuara derdhen në buxhetin e shtetit, në përputhje me legjislacionin në fushën e krijimit dhe të administrimit të të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore.
8. Publikimi i tarifave të përcaktuara në shtojcën nr.1, bëhet në faqen zyrtare të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe në mjediset e punës së Autoritetit.
9. Tarifat për fotokopjet dhe/ose kopjet në formë digjitale, regjistrimet me zë, figurë apo regjistrime të tjera, me apo pa të drejta përdorimi, për përdorim privat apo studimor, në kuadër të marrëveshjeve ndër-institucionale, do të trajtohen sipas këtyre marrëveshjeve.
10. Ngarkohet Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

## SHTOJCA NR.1

### TARIFAT PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

Nr.	Tarifa për shërbimet që kryhen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	Vlera e tarifës në lekë
1.	Fotokopje/printim bardhë e zi, Format A4 (1-20 fletë), ku përfitues janë kategoritë që trajtohen sipas ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore.	Pa pagesë
2.	Fotokopje/printim bardhë e zi, Format A4	10 lekë/ fletë
3.	Fotokopje/printim bardhë e zi, Format A3	15 lekë/ fletë
4.	Fotokopje/printim me ngjyra, Format A4	20 lekë/ fletë
5.	Fotokopje/printim me ngjyra, Format A3	30 lekë/ fletë
6.	Skanime	10 lekë/ fletë
7.	Tarifat e CD-së	50 lekë/ copë
8.	Tarifa për riprodhime të regjistrimeve me zë, figurë, apo regjistrime të tjera (pa të drejta përdorimi)	50 lekë/minutë
9.	Tarifa për riprodhime të regjistrimeve me zë, figurë, apo regjistrime të tjera për përdorim studimor (me të drejta përdorimi)	1.500 lekë/minutë
10.	Tarifa për qëllime studimore për studiuesit	20 lekë / fletë
11.	Tarifa për qëllime studimore për studentët	5 lekë / fletë